



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR CAKTIMIN E TRE QENDRAVE TË VOTIMIT NË NDËRTESEA PRIVATE, PËR
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 15.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI-	Kryetar
Denar	BIBA-	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	Bitri-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Caktimin e tre qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 93, pika 2, gërma "a", e Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

V E R E N

Kryetari i Bashkisë, në zbatim të neneve 62, pika 4, dhe 93, pika 2 dhe 3, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, në rast të pamundësisë të caktimit të vendndodhjes së QV-së në ndërtesë publike, brenda territorit të qendrës së votimit, apo në zonë votimi fqinje, ka detyrimin t'i paraqesë KQZ-së propozimin për caktimin e QV në ndërtesë private.

Kryetari i Bashkisë Vlorë me shkresën nr.2873 prot., datë 10.05.2019, ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjeve të QV nr.4476, QV nr.4482 dhe QV nr.4482/1.



Nr.376 i Vendimit

Data 15.05.2019

Ora 18.⁰⁰ e Vendimit

Per caktimin e tre qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Ndryshimi kërkohet pasi godina e stacionit të trenit, ku kanë qënë të caktuara vendndodhjet e këtyre QV, është në rikonstruksion.

Për këtë shkak, propozohet caktimi i vendndodhjeve të QV nr.4476, QV nr.4482 dhe QV nr.4482/1 në Universitetin jo publik "Reald", në tre salla, në katin e parë, sejcila me sipërfaqe mbi 70 m².

Propozimi është i shoqëruar me të dhëna dhe dokumentacion në përputhje me përcaktimet e nenit 93, pika 3, të Kodit Zgjedhor, dhe Udhëzimin e KQZ-së Nr.1, datë 12.12.2012 "Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet".

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 93, pika 2, gërma "a" të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I

1. Caktimin e vendodhjeve të qendrave të votimit nr.4476, QV nr.4482 dhe QV nr.4482/1, në Universitetin jo publik "Reald", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.
2. Kryetari i Bashkisë Vlorë të kryejë menjëherë lajmërimin me shkrim të zgjedhësve për vendndodhjet e qendrave të votimit, të caktuara me këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

